



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr.

5895

Data: 29.07.2022

PROCESVERBAL I RAPORTIT GJASHTËMUJOR TË PUNËS SË KRYETARIT

Procesverbali nga Raporti gjashtëmuor i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit, të mbajtur me datën 30.06.2022, duke filluar nga ora 15:00 në sallën e koncerteve në Shtëpinë e Kulturës “Imri Curri” në Han të Elezit me gjithsej 84 pjesëmarrës. Për prezentimin e Raportit, prezent ishte **Mehmet Ballazhi** (Kryetari i Komunës), **Sevdi Dernjani** (Nënkryetari i Komunës), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës së Përgjithshme), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor përbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Kimete Kuka-Hasallari** (Drejtoresh e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik) dhe **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport).

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin publik mbi raportin gjashtëmuor të punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit dhe theksoi se ky raport do të prezentohej nga drejtorët dhe drejtoreshat e drejtorive përkatëse, ku secili do të prezentojë punën e bërë në drejtoritë e tyre, dhe një pjesë do ta prezentojë vet Kryetari apo për ndonjë plotësim do të përgjigjet edhe Nënkryetari i Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Raporti gjashtëmuor i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit

Mehmet Ballazhi thekson: Kemi arritur 11 marrëveshje:

1. Marrëveshje me Komandën e Jugut për aktin e donacionit të furnizimit me panele solare pranë komunës së Hanit të Elezit,
2. Komuna e Hanit të Elezit nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën Kosovare për Talent dhe Arsim – TOKA,
3. Marrëveshje për shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura në mes të Komunës së Hanit të Elezit dhe KRU "Bifurkacioni" SH.A,
4. Marrëveshje për depozitimin e mbetjeve inerte të krijuara nga Komuna Hani i Elezit si një material i mbushjes së pasme në guroren e Dimcës,

5. Memorandum Bashkëpunimi mes Komunës Hani i Elezit dhe komunës shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Komunës së Tearcës,
6. Memorandum bashkëpunimi Komuna Hani i Elezit me organizatë YIHR KS,
7. Marrëveshje bashkëpunimi Komuna e Hanit të Elezit dhe Caritas-i Zvicerian për projektin “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” (YENI),
8. Marrëveshje bashkëfinancimi ndërmjet Komunës së Hanit të Elezit dhe MAPL,
9. Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komunës Hani i Elezit dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Ferizaj,
10. Marrëveshja mes Komunës Hani i Elezit dhe Qeverisë së Kosovës për “Kartën e Gjelbërt”,
11. Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës Hani i Elezit dhe Illyrian shpk për platformën digjitale eShkollori.

Projektet e hartuara:

1. Hartimi i projektit të rrugës Krivenik-Gorancë,
2. Projekti i fazës finale të Qendrës Kulturore të Rinisë,
3. Projekti i asfaltimit të rrugës Ramuka-Paldenicë,
4. Projekti i kanalit të hapur në fshatin Paldenicë (IPA fondet),
5. Projekti i mureve mbrojtëse,
6. Projekti i Parkut të Qytetit,
7. Projekti i rregullimit të hapësirave përreth Komunës,
8. Projekti i urës shtesë te ura e Seqishtës,
9. Projekti i vendosjes së ashensorit në objektin e Komunës,
10. Projekti i shtrimit me kubëza të rrugicave në zonat urbane dhe rurale etj, I cili rrjedh nga një grand i fituar me MAPL në vlerë prej 30 mijë €, dhe do të bashkëfinancohet edhe nga Komuna me diku në vlerë prej 70 mijë €.

Projektin e urës së Seqishtës dhe të ashensorit i ka bërë falas një arkitekt i quajtur Pajazit Gjoni, ndaj të cilit jemi shumë falënderues.

Ndërsa tani, gjithkush nga drejtoritë do të prezentojë punën e drejtorive të tyre.

Sevdi Dernjani thekson: Krahas të gjitha projekteve dhe marrëveshjeve që i përmendi Kryetari i Komunës, unë do të ndalem tek disa punë më në veçanti., të cilat ne kemi arritur që t’i kryejmë prej janarit 2022 deri tani. Është realizimi i shujtave të arsimtarëve, obligim i viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Gjithashtu vlen të theksohet edhe asgjësimi i barnave me afat të skaduar ku ka qenë një deponi e krijuar prej vitit 2012 me barna të tilla në Qendrën për Punë Sociale. Dy nga projektet që kanë rëndësi të veçantë janë projekti i rrugës Krevenik-Gorancë në vlerë rreth 1 milion e 200 mijë € dhe asfaltimi i rrugës Paldenicë-Lagjja Ramuka në vlerë prej 220 mijë €, ku kemi pasur takime me zv.Ministrin e Infrastrukturës z.Hysen Durmishi, i cili na ka premtuar se së shpejti do të nënshkruajmë një marrëveshje bashkëpunimi për këto projekte.

Natyra Kalisi thekson: Detyrat tona në Administratë janë përkushtimi ndaj shërbimeve të qytetarëve, ku mundohemi që shpejt dhe me efikasitet t’i adresojmë me kohë çdo kërkesë, ankesë

dhe lëndë të gjendjes civile. Drejtoria jonë përkushtohet për miratimin dhe funksionimin e rregullt të sistemit Intranet. Gjithashtu kemi vendosur pajisjen për monitorimin e vijueshmërisë në punë, në bashkëpunim me ASHI-në në kuadër të MAPL-së. Është zgjeruar rrjeti brenda objektit komunal, e cila më herët ka munguar diçka e tillë. Gjithashtu kemi marrë pjesë në trajnime, seminare dhe konferenca, të cilat do ta rrisin shpejtësinë dhe efikasitetin në Administratën Komunale. Numri i kërkesave në Gjendjen Civile është vazhdimisht në rritje, në krahasim me vitet paraprake. Një iniciativë e marrë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit është formimi i Këshillave të Fshatrave dhe Vendbanimeve, të cilat nuk kanë qenë funksionale prej vitit 2019, sepse ju ka skaduar mandati. Këshillat i kemi të dnrë në 4 bashkësi lokale. Kemi filluar transmetimin e seancave live të mbledhjeve të Kuvendeve Komunale. Kemi vendosur edhe mbishkrimet digjitale në hyrje të Komunës dhe tek Qendra e Shërbimit të Qytetarëve. Kemi kryer edhe shumë punë të tjera, të cilat kryesisht lidhen me shërbimin ndaj qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Lindita Ballazhi thekson: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kryesisht ka funksionuar në tre sektorë: 1) Sektori për Buxhet dhe Financa; 2) Sektori i të Hyrave; 3) Sektori i Tatimit në Pronë. Fillimisht, ne kemi bërë përpilimin dhe përgatitjen e rrjedhjes së parasë, prej të gjitha programeve dhe nënprogrameve buxhetore në zotimet dhe shpenzimet e parashikuara të mjeteve buxhetore sipas planifikimit nëpër të gjitha kategoritë ekonomike, si: Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shpenzime, Shpenzime komunale, Subvencione dhe Transfere, si dhe Investime Kapitale. Aktivitetet të cilat janë kryer në sektorin Buxhet dhe Financa kanë qenë të shumta, ku më të rëndësishmet janë: përgatitja e propozim vendimit për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga të hyrat vetanake 2020 dhe 2021 në vitin vijues 2022 në shumë prej 72,737.76€. Kemi pasur tre projekte kapitale të cilat kanë kaluar në kategorinë e rezervave, andaj këto mjete në vlerë prej 15,000.00 €, kemi marrë vendimin që t'i transferojmë në projekte të tjera ekzistuese kapitale. Kemi përgatitur raportin e konsoliduar analitik të bilancit të gjetjes të vitit 2021 dhe të njëjtin e kemi publikuar në uebfaqen e Komunës. Është përgatitur dhe është hartuar Raportet mujore dhe Raportet tremujore, të cilat çdoherë publikohen në uebfaqen komunale. Kemi përgatitur pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe janë përcjellë në Ministri të Financave në Departamentin e Thesarit. Gjatë muajit prill kemi pasur Auditimin e Jashtëm për vitin 2021 dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit, si dhe kemi pranuar Raportin final të auditimit, ku kemi pasur 8 të gjetura, prej të cilave 7 janë të reja dhe 1 e bartur vite pas vite për e-Pasurinë, e që poashtu ky Raport është i publikuar në uebfaqe të Komunës. Kemi mbajtur tre Debate Publike në tre lokacione në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), duke pasur parasysh rëndësinë që ka në planifikimin buxhetor. Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për çdo muaj barazohemi me Thesarin. Kemi realizuar ekzekutimin e shujtave për mësimdhënësit dhe pagat jubilarë në kuadër të arsimit dhe të shëndetësisë. Poashtu, kemi realizuar pagesën për shumë obligime të trashëguara, të cilat datojnë që nga viti 2016, ku shuma totale e obligimeve të vjetra që janë shlyer pas marrjes së mandatit tonë qeverisës është 228,667.13€ . Tek sektori i të Hyrave, kemi realizuar këto aktivitete: kemi bërë përgatitjen e raporteve mujore dhe tremujore e të hyrave vetanake për barazim me Thesar, përgatitjen e raporteve për të hyrat vetanake për çdo muaj sipas llojit të të hyrave dhe sipas drejtorive, dhe publikimi i të njëjtave në uebfaqen komunale. Planifikimi i të hyrave për vitin 2022 është 381,347.00€, ku deri në ditën e sotme, Komuna Hani i Elezit ka inkasuar 158,416.91€ apo 41.5% e planifikimit total të të hyrave. Kemi edhe sektorin e Tatimit në Pronë, ku gjatë kësaj periudhe , ky sektor ka pasur këto aktivitete: gjatë muajit shkurt kemi pranuar linkun për faturat e tatimit në pronë dhe shpërndarja e tyre ka filluar nga muaji mars deri në muajin qershor, ku

numri total i faturave të tatimit në pronë është 3477 dhe në këtë periudhë kemi pranuar 76 kërkesa për korrigjim të certifikatës së pronës, si dhe 26 ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë. Gjatë kësaj periudhe, kemi arritur të bëjmë 18 marrëveshje për pagesë me këste të tatimit në pronë, e kjo është një metodë që ua lehtëson tatimpaguesve që kanë vlera të mëdha në fatura. Faturimi i tatimit në pronë dhe në tokë për vitin 2022 është 225,572.00€ dhe deri në muajin qershor kemi arritur t'i inkasojmë 97,415.35€, ku përfshihen borxhet, kamatat dhe ndëshkimet në vitet e kaluara.

Nexhmedin Daci thekson: Nga parafolësit pothuajse u përmendën shumica e projekteve, dhe unë po i ripërsëriti me pak më shumë detaje: tek fabrika e ujit punimet janë në përfundim e sipër, ku investimi kap shumë prej më shumë se 500 mijë €, e në ditët në vijim pritet aktivizimi i saj dhe shumë shpejt do të vendosen edhe orëmatësit në pjesën e qytetit nën magjistrale, ku për këtë qëllim, Komuna ka ndarë edhe 30 mijë € shtesë ; kanë përfunduar punimet finale në Qendrën Kulturore të Rinisë dhe është bërë hapja solemne e kësaj qendre, ku faza finale ka kushtuar afërsisht 270 mijë €, ndërkaq i gjithë projekti ka kushtuar afërsisht 1 milion e 200 mijë €, prej të cilave 730 mijë € ka qenë donacion i Ministrisë së Kulturës, kurse pjesa tjetra qenë financim i Komunës ; shumë shpejt pritet të nisnin punimet në parkun e qytetit me vlerë mbi 200 mijë € ; këto ditë pritet të fillojnë punimet në projektin “Rregullimi i hapësirave përreth Komunës dhe Postës”, vlera e të cilit pritet të jetë mbi 20 mijë € ; është shpallur tenderi për projektin kapital “Shtrim me kubëza të betonit të rrugicave në zonat urbane dhe rurale” me vlerë të projektit rreth 70 mijë €, prej të cilave 30 mijë € janë donacion nga MAPL-ja; pritet në vijim të shpallet tenderi për projektin kapital “Rregullimi i kanalizimeve në zonat urbane dhe rurale”, si dhe projekti “Hapje, zgjerim dhe shtrim me asfalt të rrugëve në zonat rurale”; në kuadër të projektit kapital “Shpronësime” është hartuar elaborati i shpronësimit të parcelës të fabrika e ujit, për shkak se ajo parcelë figuron në emër të SharrCemit dhe menaxhohet nga AKP-ja, ku kemi qenë të obliguar me i nis procedurat e shpronësimit; është shpallur fituesi për vendosjen e tabelës digjitale në afërsi të Sh.F.M.U. “Ilaz Thaçi” me vlerë prej 18 mijë € ; kemi edhe një projekt madhor “Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc” i cili ka shumë të madhe dhe ne kemi konkuru me këtë projekt pranë Bankës Botërore , të cilët e kanë miratuar këtë projekt dhe tani është në dorë të Qeverisë së Kosovës, të cilët fillimisht ata duhen me miratuar e më pas duhet miratuar edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës , për shkak se kjo kishte me qenë kredi ndërkombëtare ; në bashkëpunim me Komunën e Kaçanikut kemi konkuruar pranë UN Habitatit dhe MAPL-së me projektin kapital “Rregullimi i shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë përgjatë lumit Lepenc-Uji i Thartë-Kaçanik”, paramasa e këtij prijekti është mbi 700 mijë € ; në projektin “Ndërtimi i urës shtesë-Secishtë” kemi konkuruar pranë Ambasadës së Japonisë, ku në këtë projekt më shumë ka punu drejtoresha Majlindë, por jo vetëm në këtë projekt por edhe në shumë projekte të tjera e kemi pas krah të djathtë ; në bashkëpunim me Komunën e Tearcës do të konkurojmë në thirrjen e parë të IPA Fondeve të Bashkimit Evropian me projektin “Rregullimi i kanalit të hapur në fshatin Paldenicë”, vlera e të cilit është mbi 100 mijë € ; para pak ditësh kemi vendosur bashkëpunim me Komunën e Ilindenit të Maqedonisë së Veriut, ku do të konkurojmë në thirrjen e dytë të IPA Fondeve; kemi konkuruar me tre projekte në KFOR-in Polak, secili projekt në shumë prej 15 mijë € apo 45 mijë € si shumë totale, ku jemi përcaktuar që njëri projekt të realizohet në çerdhe, një në Sh.F.M.U. “Ilaz Thaçi” dhe një në Qendrën Kulturore të Rinisë ; jemi përfutues të dy projekteve nga IOM (Organizata Ndërkombëtare e Migrimit), njëra në shumë prej 1 mijë e 500€, e cila është realizuar, përkatësisht për ndriçimin e xhamive për muajin e Ramazanit dhe projekti tjetër në shumë prej 3 mijë € , që do të realizohet në Qendrën Kulturore

të Rinisë për vendosjen e zërimit në Sallën e Konferencave. Siç e tha edhe Kryetari i Komunës, kemi hartu mjaft shumë projekte për këtë pjesë të vitit dhe që jemi të përkushtuar që t'i realizojmë disa sivjet e disa në vitet e ardhshme.

Hisni Luri thekson: Po e filloj raportin e drejtorisë me një nga projektet ma të rëndësishme që kemi realizu e që është eShkollori, e cila është një platformë që mundëson komunikimin efektiv mes mësimeve, nxënësve dhe prindit, duke iu ofruar qasje përmes një llogarie, ku prindërit përmes një web aplikacioni apo mobile mund të qasen në eShkollor për tu informuar për vijueshmërinë arsimore të fëmijëve të tyre, ndër këto informacione janë njoftime të përgjithshme nëpër shkolla, suksesin e nxënësve në kohë reale, orarin mësimor, raporte të ndryshme, komunikime përmes chat-i e të tjera, mësimeve mund të bëjnë planifikime, plane mujore, vlerësimet e nxënësve, paraqitje e detyrave, regjistrimi i kuizit online, testet, asociacionet, kalendaret e aktiviteteve , testet online, komunikimet me nxënës përmes dhomave të bisedave. Sa i përket shujtave, i kemi realizu shujtat e kontratave kolektive që i kemi pas si obligime. Projektet që kemi apliku te KFOR-i Polak, po i përshkruaj më detajisht se çka përfshijnë këto projekte, njëri prej tyre ka të bëjë me pajisjen e secilës klasë me tabela digjitale 86 inç në Sh.F.M.U. “Ilaz Thaçi”, njëri projekt përfshin pajisjen e çerdhes me inventarizim dhe shtretër, dhe projekti i tretë përfshin vendosjen e një ekrani digjital në Qendrën Kulturore. Sa iu përket subvencioneve, ne si drejtori kemi subvencione vetëm për OJQ-të. Te çështja e bursave, siç dihet ne këtë vit kemi përfshi si përfitues secilin student që ka aplikuar, si dhe kemi bërë plotësim-ndryshimin e rregulloren mbi ndarjen e bursave, ku këtu përfshihen edhe studentët që studiojnë jashtë shtetit të Kosovës, përkatësisht në Maqedoni të Veriut dhe në Shqipëri, të cilëve do të iu takojnë 10 bursa. Drejtoria jonë ka zhvilluar të gjitha manifestimet, përkujtimoret, festat zyrtare, shënimet e ditëve me rëndësi e të ngjajshme.

Kimete Kuka Hasallari thekson: Në kuadër të drejtorisë time përfshihet Qendra e Kujdesit të Mjekësisë Familjare, Ambulanca e Mjekësisë Familjare dhe Qendra për Punë Sociale, të cilat janë tre qendra që ofrojnë shërbime mjekësore dhe sociale për qytetarët tanë. Kam veçuar disa aktivitete që janë në kuadër të drejtorisë që e menaxhoj unë: me 1 mars të këtij viti është bërë rifunksionalizimi i AMF-së në fshatin Gorancë ; projektin e punimit të tavanit të QKMF-së që është pjesë e projektit të ngrohjes ; projekti i asgjësimit të barnave që ka qenë problematikë si ër ne dhe qytetarët, ne jemi pothuajse në përfundim të këtij procesi, ku kemi bërë regjistrimin e të gjitha barnave me afat të skaduar që nga viti 2012, tani po e presim vetëm Inspektoriatin Farmaceutik që të japë lejen e asgjësimit ; është bërë riparimi i aparatit të Rentgenit që s'ka qenë funksional prej 7 muajsh me radhë dhe nga ky muaj aktual, aparati është funksionalizuar ; me 30 maj janë realizuar të gjitha pagat jubilarë në shëndetësi për punonjësit që kanë mbi 20 e 30 vjet përvojë pune. Nga QPS-ja, duke pasur parasysh gjendjen me pandeminë dhe ngritjen e çmimeve, kemi pasur bashkëpunime me organizata dhe shoqata të huaja dhe vendore, që sado pak kanë lehtësuar jetesën e familjeve në nevojë dhe asistencë sociale, ku po i rendis si në vijim: 120 pako donacion nga disa organizata si “Ilove2Help”, “Infaq e V” dhe “Illirian Group” , 200 pako në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Hanit të Elezit dhe një organizate turke “T.C. Vakiflar Genel Mudulugu” në muajin Ramazan ; 109 pako nga Islamic Relief Kosova ; 40 pako nga Ambasada e Emirateve të Bashkuara Arabe ; 150 pako nga Shoqata Bamirëse e Kosovës “Nëna Tereza”.

Arsim Dernjani thekson: Ne si drejtori kemi pasur shumë aktivitete, duke filluar nga provizimi i kompanisë për mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik dhe fekal; intervenimin e rregullt të shenjave; aktemërimet të rrugëve; aktivitetet e ndërmarra për festat lokale, pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, mirëmbajtjen e flamujve kombëtar dhe punë të tjera të specifikuar në Marrëveshjen në mes komunës dhe kompanisë NPL Pastrimi sh.a ; mirëmbajtja e ndriçimit publik në zonat urbane dhe rurale; aktivitetet e ndërmarra për 11 Qershorin ditën e Çlirimit, realizimi i projektit “Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në Han të Elezit; bashkëpunimi me CDI , KRU “Bifurkacioni” , TEUTA për rehabilitimin e ujësjellësit të Dimcës ; takime të rregullta me KFOR-in Polak, Italian, FSK, AME, Policin e Kosovës ; inspektimet e rregullta të shenjave, dhe taksive nga inspektori i komunikacioni ; vendimi për themelimin e grupit punues për revidimin e planit për menaxhimin e mbeturinave. Nga sektori I Komunikacionit ka pasur inspektime të vazhdueshme në zonën kufitare ku janë inspektuar taksistët dhe është bërë ndjekja e taksistëve ilegal, e ku numri i inspektimeve për këto gjashtë muaj ka qenë afro mbi 100 inspektime, poashtu janë regjistruar 21 taksistë dhe një operator që operon në linjat Gorancë – Rezhancë – Hani i Elezit dhe anasjelltas. Nga sektori i Emergjencave, të rastet e intervenimeve nga NJZPSH, numri i ndaljeve ka qenë 22, numri i zjarrve 18, numri i shërbimeve 1 dhe aksidente rrugore 2. Nga sektori I Ndërtimit, janë mbajtur 3 procesverbale, 1 vendim për ndërtim pa leje, 1 urdhëresë, 20 inspektime të punimeve në terren, 1 përgjigje në kërkesë, 2 leje ndërtimore. Dhe për fund, duke falënderuar Kryetarin dhe SharrCemin, është bërë një punë e mire në fshatin Gorancë, ku nga sot nuk do të ketë problem për ujë.

Abdurahman Bushi thekson: Drejtoria e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural ka qenë e përkushtuar në organizimin sa më të mirë të punës, në mënyrë që t’iu ofrohen shërbime sa më të mira të gjithë banorëve të Hanit të Elezit. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 kemi pasur disa aktivitete, duke filluar prej muajit Janar deri në muajin Qershor 2022 , e ata janë: kemi pasur konfiskime të drunjve me një sasi prej 61.8 m3 të gjitha janë shkarkuar në depo të komunës dhe janë bërë fletëparaqitje për në gjykatë; nga rojtarët e pyjeve janë dorëzuar 136 fletëparaqitje, 122 fletëparaqitje kundërvajtje dhe 14 fletëparaqitje penale me një masë drusore prej 115.92m3 dhe në dëmin e llogaritur prej 16127.11 € ; në pyjet private kemi pranuar 17 kërkesa për prerje të drunjve në teritorin e komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 të gjitha kërkesat kanë qenë të dorëzuara në afat deri më 31 Mars, ku është e paraparë me ligj; nga gjykata kemi pranuar 72 vendime, prej tyre 67 vendime pozitive , 4 vendime parashkrim dhe 1 vendim qortim; të hyrat nga APK-ja për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 kanë qenë 257.00€; kërkesa për ndërrim destinimin e pronave private kanë qenë 2 kërkesa; thirrje publike për furnizim të lirë të qytetarëve me drunj për ngrohje nga pyjet publike nga data 21/06/2022 deri më 05/07/2022; subvencionet janë kryer vetëm për subvencione direkt nga Ministria ku kanë aplikuar 92 fermer (101 fermer në vitin 2021); Kemi formuar 4 komisione, dhe ato janë: 1. Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për prerje të druve në pyjet private, 2. Komisionin për regjistrimin e dëmeve pyjore, 3. Komisionin për dëmet e shkaktuara nga ariu, si dhe 4. Komisionin për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore; kam dorëzuar në MBPZHR-në projektin për “Ndërtimin dhe rehabilitimin e kanalit të ujitjes ‘Lloka’ “ më 10/06/2022, me L=253m dhe vlerë 14,719.50 euro.

Majlinda Kaloshi thekson: Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit kalendarik 2022, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka marrë pjesë në të gjitha takimet, konferencat dhe punëtoritë që i përkasin sferës së zhvillimit ekonomik dhe atij turistik me interes për Komunën e Hanit të Elezit.

Për sa iu përket projekteve, Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Urbanizmit përmendën projektet për të cilat ne kemi punu ngushtë dhe kemi arritur me i hartu disa projekte që janë me interes për Hanin e Elezit. Nuk po i përsëris edhe një here ato projekte që u përmendën deri tani, por po i shtoj edhe dy projekte, njëri nga to është nga MAPL në kuadër të projektit “Komuna për të Rinjtë “-M4Y, nga ku janë 5 projekte përfituese të të rinjve të komunës tone, ku vlera totale e përfitimit nga ky project për të pestë përfituesit arrin shumë prej 24,593.10€, si dhe projekti i dytë është hartimi i projektit “Vendosja e tabelave digjitale në rrugën “Adem Jashari”, ku i njëjti është dorëzuar në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal tek “Programi Për Zhvillimin Rajonal”, ku pjesa administrative është në rregull, por jemi njoftuar që Ministria të paktën këtë vit nuk do të mundë që ta realizojë këtë projekt, por kjo nuk do të thotë që herave të tjera nuk do të konkurojmë sërish. Për sa i përket sektorit për regjistrimin e bizneseve, gjatë këtij viti kemi pasur 6 biznese të reja që janë hapur dhe ne si drejtori iu kemi ofruar kushte dhe lehtësime e të bërit biznes, ku për gratë nuk do të paguajnë taksa komunale për 4 vite radhazi, kurse për burrat kjo vlen për dy vite. Ndërkaq kemi pasur 7 biznese që janë shuar, që vjen si pasojë e rritjes së çmimeve, të cilat normalisht bizneset private kanë qenë më të prekurat. Pjesa e Inspektoriatit të Tregëtisë, akoma pa u përmbyllur gjashtëmujori i parë i vitit 2022, kemi arritur një shumë prej 12 mijë € të inkasimit të taksave për veprimtari të bizneseve.

Mehmet Ballazhi thekson: Në fillim, kur thash Raporti i punës që kemi bërë, kjo nuk do të thotë se është punë e bërë vetëm nga Kryetari, Nënkryetari dhe drejtorët/drejtoreshat, por kjo Raport përfshin punën e institucionit të Komunës së Hanit të Elezit, ku ne jemi mundu që të bëjmë një punë ekipore, e cila ka dalë me produktive dhe efektive, e që gjithsesi besoj se na kanë mbetur edhe shumë punë të tjera që i kemi bërë e nuk i kemi theksu sot këtu, duke mos përfshirë takime të shumta që realizojmë me persona fizik dhe organizata. Siç e përmendi drejtori i Shërbimeve Publike, projekti i ujit në Gorancë ishte projekti i fundit që edhe pse ka qenë i paplanifikuar, por i realizuar me një përpjekje e përkushtim maksimal edhe nga unë si Kryetar Komune, edhe nga Kryetari i Këshillit të Fshatit Gorancë, z. Shefketi me bashkëpunëtorët e tij, që e kemi prezent edhe sot këtu, por një falënderim të veçantë drejtorit të Shërbimeve Publike bashkë me menaxhmentin, të cilët i kanë ofruar pajisjet dhe gjithë punën e bërë deri në funksionalizim të ujit. Gjithsesi, në vazhdimësi do të ketë projekte të tjera nëpër të gjitha lokalitetet e Hanit të Elezit. Tani, unë do të ju kisha lutur që edhe ju të bashkëpunëtoni këtij debate publik, të na jepni vërejtjet tuaja, me qëllim që ne të mund të përmirësohemi në gjashtëmujorin e dytë.

Basri Maliqi thekson: Unë jam zyrtar komunal në zyrën e gjendjes civile, dhe di që Drejtoresha e Administratës ka marrë një iniciativë dhe desha të di se ku ka arritur vullneti apo përkrahja juaj për bashkëpunim me diasporën. Dhe çështjen e dytë e kam për Drejtorin e Arsimit, prapë për diasporë, është mirë që të ketë një organizim nga Komuna për pritjen e mysafirëve nga diaspora.

Natya Kalisi thekson: Para dy ditëve, ne kemi pasur një diskutim me Kryetarin e Komunës, ku e kemi një ide për ofrimin e shërbimeve vetëm për diasporën, e cila lidhet me një linjë telefonike pa pagesë, ku diaspora mund të thërrasin për kërkesa, ankesa, apo dokumentacione personale.

Hisni Luri thekson: Kurse te pjesa e Drejtorisë për Kulturë, kam menduar që të hënën të kem një takim me Zyrtarin për Kulturë dhe me Pedagogët e Sportit, ku po mendojmë të organizojmë diçka enkas për diasporën. Do të ju njoftojmë me kohë për gjithçka.

Mehmet Ballazhi thekson: Po e plotësoj drejtorin e Arsimit për aktivitetet që i kemi planifiku apo që po mendojmë t'i realizojmë për diasporë. E di që edhe viteve tjera ka pas një aktivitet për diasporën, e që ka qenë një ditë takimi me diasporën. Kurse këtë vit, kemi mendu që të jenë dy si lloj koncerte apo manifestime për diasporën, një do të jetë rreth 15-20 korriku dhe tjetri do të jetë në javën e parë të muajit gusht, që me qenë ma gjithëpërfshirës për diasporën, edhe për ata që vijnë në korrik, edhe ata që vijnë në gusht për pushime. Për shkak se me 29 gusht është Dita e Dëshmorëve dhe edhe me këtë ditë do të ketë organizime gjithëpërfshirëse.

Nexhibe Kalisi: Jam mësimdhënëse në Sh.M.L. "Dardania". Fillimisht ju përgëzoj për punën që e keni bërë deri më tani, është për tu vlerësuar vet fakti që nëpër drejtorin keni zgjedhur njerëz të rinj e profesionalë, që po jepet shumë shpresë për të rinjtë dhe më saktësisht edhe për nxënësit me të cilët unë punoj çdo ditë. Pytjet e mia janë këto: ne nga Lagjja e Re, çdo ditë po përballemi me kolonat e kamionëve dhe desha të di, a keni ndërmarrë diçka për rregullimin e kësaj çështje apo nëse keni mendu për zgjidhjen e problemit duke krijuar ndonjë rrygë dytësore apo alternative, kur dihet se mund të ketë edhe emergjenca të njerëzve e shpesh rruga është e bllokuar dhe duhet pritur deri në gjysëm ore; pyetja tjetër është për Kryetarin dhe Drejtorin e Arsimit, duke qenë se ju më herët keni qenë mësimdhënëse, në cilin aspekt tentoni që ta fuqizoni sistemin arsimor dhe cili është prioriteti juaj për shkollat e Hanit të Elezit?

Mehmet Ballazhi: Tek çështja e rrugës kah kalon tek kufiri, unë edhe vet i takoj asaj lagje dhe për çdo ditë detyrohem me e kalu atë rrugë dhe diku rreth 40% e qytetarëve të Komunës e frekuentojnë atë lloj rruge që po e quaj si rrugë fyti. Ne jemi mundu që në raste të veçanta, kemi komunikuar me Policinë e Kosovës, të cilët kanë qenë të gatshëm të ofrojnë shërbimet e tyre përkundër, e për të cilën u jam falënderues për këtë. Për një zgjidhje ma t'qëndrueshme dhe ma afatgjate, ne e kemi një projekt për zgjerimin e rrugës, por janë disa procese të shpronësimit që janë me muaj në Qeveri dhe nuk po përshpejtohen procedurat e shpronësimit. Si një plan apo alternative që e kemi është që ajo pjesa e lokaleve që janë te kufiri, vitin e ardhshëm do të rrënohen dhe do të krijohen rrugë alternative dhe më nuk do të jetë problem komunikacioni civil i qytetarëve. Kjo do të merrë kohë dhe do të na kushtojë në buxhet, por vitin e ardhshëm do të jetë çështje e kryer. Po përgjigjem edhe për pyetjen e dytë e si prioritete të miat, dhe kur them të miat e kam fjalën prioritete të ekipit tim qeverisës. Digjitalizimi i shkollave do të jetë nga prioritetet për arsimin, ne kemi fillu me eShkollorin, më pas kemi tabelat digjitale, ku do të jemi komuna e parë me tabela digjitale, më pas digjitalizimi i bibliotekave dhe kabinetëve, madje ne e kemi funksionalizuar kabinetin e informatikës në shkollën fillore në Gorancë.

Driton Kaloshi: Jam zyrtar komunal në Zyrën e Financave. Vitin e kalum e kam pas propozu si projekt deratizimin-dezinfektimin-dezinsektimin e Hanit të Elezit dhe asnjëherë nuk është kryer, dhe a është e mundur që ky projekt me u realizu për shkak të rëndësisë që ka?

Mehmet Ballazhi: Në 2009 kur kam qenë Drejtor i Arsimit, e kemi pas bo DDD në shkolla dhe disa objekte të tjera. Nuk besoj se mund të ketë një projekt për këtë çështje, për shkak se punën e bëjnë kompanitë që janë të licensume për këtë punë, ne është dashtë vetëm një marrëveshje, memorandum apo pagesë shërbimesh me e bo me ta.

Mirsad Qajani: Jam administratori i vendbanimit Hani i Elezit. E kam një pyetje për Kryetarin, i cili e ka pas përmend ndërtimin e një shkolle fillore në Lagjen e Re dhe sot nuk u përmend askund shkolla. Jemi të interesum me dit se çka do të bëhet me këtë çështje?

Mehmet Ballazhi: Arsyeja pse nuk e përmenda sot këtu është sepse qëllimi i këtij debati sot është rreth punës që është bërë për 6 muajt e parë të 2022 dhe për të gjithë si njoftim po ju them se jam shumë i interesum për ndërtimin e një shkolle fillore në Lagjen e Re dhe ka shumë procedura, fillimisht është gjetja e një lokacioni të përshtatshëm për të cilin edhe jemi përcaktuar dhe duhet pagesa e atij lokacioni që është privat. Për këtë çështje, ne i kemi udhëheqë disa bisedime me pronarët e asaj toke dhe e di se është në proces e sipër krijimi i një fondacioni apo shoqate për mbledhjen e mjeteve të mjaftueshme për blerjen e asaj parcele, për shkak se komuna nuk mundet me e ble, Qeveria nuk investon në lokacione për shkolla, por do të jetë një iniciativë për zhvillim të komunitetit, ku do të kenë mundësi të gjithë të kyqen në këtë lloj fondacioni, si nga qytetarë vendorë, nga diaspora, nga qytete të tjera, por edhe nga shtete të tjera, sidomos nga Maqedonia e Veriut, ku kam bisedu me disa biznese dhe janë të gatshëm të kontribuojnë dhe ndoshta vitin e ardhshëm do të fillojmë të bëjmë kërkesa për fillimin e procedurave për ndërtimin e një shkolle në Lagjen e Re. Përveç kësaj, qëllimi i blerjes së asaj parcele rreth 65 ari është edhe ndërtimi i një fushe të hapur të sportit, për rekreacion dhe eventualisht edhe për ndonjë çerdhe.

Habib Thaçi: Ju përgëzoj për punën që e keni bërë brenda 6 muajve. Tek marrëveshjet që i keni nënshkruar, më la përshtypje njëra nga to rreth paneleve solare. Kisha dashtë me dit ku është parapa me u realizu ky projekt, në cilin objekt dhe si sugjerim për të ardhmen, me e pas parasysh nëse është e mundur që ky lloj projekti me u realizu edhe në institucionet tjera, shembull te QKMF-ja apo nëpër shkolla. Pyetja tjetër është drejtorin e urbanizmit rreth parkut të qytetit, se a ka dalë në dëgjim publik ky projekt?. Një çështje edhe te administrata, që e përmendi edhe Basria, që gjatë kohës sa janë mërgata, me qenë administrata pak ma shumë fleksibil. Tek drejtoria e Arsimit, ju përgëzoj për projektin e Shkollori, që më ka lënë përshtypje shumë të mira.

Mehmet Ballazhi: Panelet solare janë 10kW të instaluar te objekti i Komunës, e cila është punë e kryer. Ne kemi dy marrëveshje të tjera, me dy komuna, njëra me Komunën e Tearcës, me të cilët jemi përvaktuar me realizimin e përrockës në Paldenicë dhe tjetra me Komunën e Ilindenit me të cilët kemi zhvillu takime e ka shumë gjasa që të hyjmë me fotovoltaiKET apo me energji solare, në thirrjen e dytë të IPA Fondeve. Pastaj projektet që ne i kemi paraparë me projeksionet buxhetore t'i fusim ne si kategori ekonomike për me kap mundësinë e zhvillimit të procedurave për realizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Komunën e Ilindenit, përkatësisht që kemi zhvillu takime dhe së shpejti do ta nënshkruajmë atë marrëveshje.

Vaid Daci: Ju përgëzoj për punën e bërë deri tani. Unë kam dy pyetje konkrete: e para ka të bëjë me projektin që po zhvillohet te hekurudhat, për të cilat pat edhe protestat dhe çka u zhvillu deri më tani me këtë çështje rreth mbikalimeve apo nënkalimeve dhe pyetja e dytë është në lidhje me shujtat e shërbyesve civilë, duke qenë se u përmendën shujtat e realizuara për mësimdhënësit, atëherë çka për shërbyesit civilë, a me shku edhe ne përmes Gjykatës për me na u realizu?

Majlinda Kaloshi: Kur e kena hartu projektin e parkut të qytetit, ne e kemi shpall në debat publik, ku ka pas pjesëmarrës të shumtë, arkitektë e inxhinierë dhe të fushave të ndryshme. Gjatë procesit të hartimit, ne i kemi marrë tre kategori të ndryshme të shoqërisë: moshat e reja, moshat

e mesme dhe moshën e shtyrë. Gjatë debatit publik ne kemi marrë ide të reja ku të gjitha janë marrë parasysh dhe jemi mundu me i implementu në projekt. Debatit publik ka qenë i hapur për të gjithë dhe thirrja ka qenë e publikume edhe në webfaqen e komunës, gjithashtu edhe në rrjete sociale.

Natyra Kalisi: Po ndërlidhem te ajo që tha Habibi për administratën që do të jenë ë vend të punës gjatë gjithë orarit, që me qenë më fleksibil dhe me iu ofru shërbime të shpejta dhe të sakta, por ne kemi edhe një zyrtar që është caktu për sinjalizim dhe në momentin që vërehet se diçka nuk po shkon në rregull, ju lutemi që të lajmëroheni tek ai, i cili është Bujar Bushi dhe çdo raportim që do të bëni do të jetë anonime, sepse këtë të drejtë e mbron ligji i mbrojtjes së sinjalizuesve.

Lindita Ballazhi: Sa i përket pyetjes së Vaidit, ne prej momentit të marrjes së detyrës tonë kemi hasur në shumë obligime që kanë qenë të trashëguara dhe ne kemi qenë shumë të interesuar që t'i shlyejmë të gjitha. Për mësimdhënësit i kemi kryer, edhe për shërbyesit njëra pjesë është realizuar, kurse në muajt në vijim do të shikojmë edhe shlyerjen e obligimeve për shërbyesit civilë.

Sevdi Dernjani: Rreth pyetjes së Vaidit mbi informatën rreth punimeve në hekurudha, ne kemi dërgu me dhjetra shkresa e kërkesa që i kemi dërgu edhe Infrakosit edhe Ministrisë së Infrastrukturës, dhe si rezultat i këtyre shkresave dhe kërkesave, në vizitë na ka ardhë edhe zv.Ministri i Infrastrukturës z.Hysen Durmishi, i cili i ka vizitu dy vendkalimet të cilat sipas tyre janë ilegale, pre Ranat te lagjja e Bushve dhe te Bllaca 99, ku na premtoi se do të ketë zgjidhje. Kurse kompetencat e Komunës për të bërë diçka në lidhje me këtë çështje është shumë e vogël, si në buxhet por edhe në ndikim deri te organet qendrore për mbikalime. Një takim së fundi kemi pasur me administratorët e fshatrave dhe kryetarin e KVRL-së, si dhe kryeshefin ekzekutiv të Infrakosit, dhe kërkesa ka qenë të mundësohet nënkallim apo mbikalim por me standardet që i plotësojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar dhe nga Infrakos na u premtu që do të shikohet mundësia për një mbikalim me këto standarde. Edhe një plotësim që deshta me bo edhe ma herët, që kijeni parasysh që edhe pse jemi në 2022, ne jemi tu vepru me planin buxhetor të vitit 2021 nga ish qeverisja, e që gjithsesi ne kemi realizu edhe projekte që s'kanë qenë të planifikume.

Mevludin Kuka: Jam administrator i fshatit Seçishtë, ju falënderoj për projektet dhe ju përgëzoj për prezentimin. Lindita e elaboroi pak a shumë çështjen e tatimit në pronë dhe ne kemi dëgju shumë ankesa nga qytetarët për telashet e pronave të futura në tatim dhe të ankesave. Sa zgjat çështja e shyrimit të ankesave që nga paraqitja deri te marrja e një përgjigjeje, sepse sipas informacione ka zgjat kogja shumë ky proces? Dhe një pyetje tjetër që ndoshta është shqetësuese për neve, ku kemi mungesë të ekspertëve në fusha të ndryshme, kryesisht mjekësia, ku sa kam njohuri janë dy apo tre vajza që synojnë mjekësinë këtë vit, dhe desha të di sa mundet që qeverisja aktuale të ndikojë që të bisedohet me Dekanatin që të na jepet prioritet në pranimin e studentëve?

Lindita Ballazhi: Ankesat për tatimin në pronë janë zgjatur afatet dhe është marrë një vendim nga ana e Ministrisë dhe ky afat ka përfunduar sot me datë 30 qershor dhe tani si hap vijues është

formimi i Komisionit për shqyrtimin e të gjitha ankesave për tatimin në pronë dhe pasi të formohet ky Komision, do të shyrtohen të gjitha ankesat dhe do të ketë përgjigje për të gjitha.

Hisni Luri: Sa i përket Qendrës për Ndërmarrësi dhe Karrierë, me plitikat e reja të arsimit në vitin 2023 do të startojmë me 1 këshilltar dhe besojmë se shumica e nxënësve do të orinetohen drejt një profesioni ku mund ta gjejnë veten edhe pas përfundimit të shkollës.

Femi Ballazhi: Pasiqë jam edhe vet familjar i familjes së dëshmorit, deshta të di prej Kryetarit apo Nënkryetarit, se a ka ndonjë projekt për dëshmorët dhe familjet e dëshmorëve? U fol për parkun e qytetit, para 4 vjetësh, aty u fol që ka me u ndërtu busti i dëshmorit Gafurr Loku dhe tani as spo flitet hiç për këtë çështje, dhe deshta me dit a u hjek ai projekt apo pritet diçka me u bo në vazhdim? Dhe pyetja tjetër për të gjithë, a kanë familjet e dëshmorëve ndonjë përparësi në aspektin e shkollimit apo të punësimit?

Sevdi Dernjani: Këtë vit jemi duke operu me Planifikimin buxhetor të vitit 2021 për vitin 2022. Drejtoresha e Financave ka zhvillu debatet publike në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe ky propozim i yti kishte mujt me qenë pjesë e atij debati publik, megjithatë kjo nuk do të thotë që sot nuk e marrim parasysh këtë sugjerimin tënd për ndërtimin e bustit të dëshmorit Gafurr Lokut. Dëgjime publike do të ketë edhe në të ardhmen dhe ju kisha lutur që të jeni pjesëmarrës nëpër to dhe të jepni projekt propozimet tuaja. Kurse për pyetjen e dytë, besoj se drejtori i arsimit mundet me na informu ma shumë.

Hisni Luri: Familjet e dëshmorëve të luftës së UÇK-së ju ndahen bursa studimore pa kriterë, gjithashtu edhe për tek çerdhja, kemi marrë vendim që familjarët e dëshmorëve të lirohen nga pagesa për fëmijët që i regjistrojnë në çerdhe.

Visar Hasallari: Jam kryetari i organizatës rinore KVRL nga Hani i Elezit dhe ne si organizatë e shoqërisë civile i kemi disa kërkesa tona rreth raportimit të punës së Kryetarit. Dua të përgëzoj 50% e përzgjedhjes së femrave në qeverisje, ku edhe ne si organizatë gjithmonë e kemi pasur synim çështjen e feminizimit në institucione, duke qenë se femra në Han të Elezit ka pasur shumë pak qasje në vendimmarrje. Qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit përballen me shumë probleme, dhe ne i paraqesim këto probleme për të cilat ne si shoqëri civile nuk kemi kompetenca për me i zgjidhë. Një nga to është edhe se Komuna e Hanit të Elezit edhe në qershor të 2022 nuk ka ujë të pijshëm dhe sfidat e problemet ende kanë mbetur të pazgjidhura. Më lejoni që të cek se në Ligjin për Vetqeverisje Lokale thotë se Komuna duhet të bëjë zgjidhje për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm. Gjithashtu ajri i Hanit të Elezit është ndër më të ndoturit në Kosovë. Andaj ne duam të dimë planin tuaj në lidhje me Sharrcemin për uljen e ndotjes së ajrit. Gjithashtu ne kemi pasur takime me Këshillin e Sigurisë dhe cili është plani i Komunës për të rinjtë për parandalimin e fenomeneve negative siç janë përdorimi i substancave narkotike, ku numri i përdoruesve duke fillu nga marihuana e të tjerat është në rritje dhe veçanërisht në fshatrat e Komunës tonë.

Mehmet Ballazhi: Të falënderoj Visar për pyetjet dhe kritikën tuaj, dhe fillimisht e kam unë një kritikë për ty, jo si Visar por si shoqëri civile, sepse mënyra e paraqitjes nuk është adekuate sepse ti e din shumë mirë se si i kemi vendos ne raportet e bashkëpunimit dhe gjithsecili duhet të jetë i vetëdijshëm për kohën e shkurtë që kemi në qeverisje dhe buxhetin e limituar që e kemi shkak i

planifikimit nga viti i kaluar. Ti ke qenë pjesë e shumë takimeve, përfshirë edhe atë të KKSB-së për luftimin e dukurive negative. Mundësia e Kryetarit është me organizu takime, me dhanë ide dhe alternativa, e më pas me vepru institucionet kompetente të sigurisë për këto çështje. Pavarësisht kritikave, unë me të gjitha organizatat do të bashkëpunoj dhe kur jemi te çështja e ujit, kur Qeveria Zvicerane apo CDI-ja në bashkëpunim me Bifurkacionin dhe punëkryesin ma kanë konfirmuar zgjidhjen e ujit të pijshëm duke funksionalizu fabrikën e ujit në fund të muajit maj dhe unë ua kam dhanë një afat shtesë dhe ju kam thanë që e kanë edhe qershorin në dispozicion për me e realizu fabrikën e ujit, dhe pardje kemi pas takimin e fundit vet përfaqësuesi i CDI-së z.Alan Brown ka kërku falje për mos realizimin e punës pas garancës që ma kanë dhanë mu si Kryetar Komune, i cili gjithashtu ma ka dërgu edhe një letër ku kërkon falje, por që gjithsesi kjo kërkim falje nuk është zgjidhje e problemit , por thjesht në aspektin moral është një shfajësim nga ana e tyre. Dhe arsyeja që ne përqindjen më të madhe të fokusimit për ujin e pijshëm e kemi në qendër sepse përfundon mandati i CDI-së si program, megjithatë çështja për zgjidhjen e ujit do të jetë e vazhdueshme deri në realizim të plotë. Ne jemi në fazën finale, që sipas ecurisë së punëve, do të jetë fundi i korrikut kur fabrika do të funksionojë, ujë do të ketë edhe para kësaj, por ujë të pijshëm siç ne e kemi planifiku në bazë të preferencave të tyre, ka qenë që do të jetë fundi i qershorit. Provat e fabrikës me pajisjet e makineritë që janë të instalume prej vitit 2010 janë bërë dhe e mira është që ato funksionojnë, por edhe KEDS-i është një nga faktorët neglizhent në këtë çështje, të cilët kur kanë bo lidhjen e trafos, ata i kanë marrë gabim specifikat dhe masi i kanë vendos, e kanë vërejt mospërshtatshmërinë dhe më pas u dashtë me i rifillu nga pika zero të gjitha procedurat, si për licensim e të tjerat me radhë, dhe specifikat e trafos të përshtatshme për komunën tonë nuk janë të gatshme në treg dhe duhen me u porosit , që veç i kanë porosit por nuk janë gati hala, ku duhet kohë për prodhim, për marrje të licensën, për trajnimin e punëtorëve kompetent e shumë procedura tjera, që diku i merr 1 muaj i gjithë ky proces për funksionalizimin e fabrikës.

Sevdi Dernjani: Visar, ne të falënderojmë për pytyet konstruktive që vazhdimisht i bën dhe gëzon respektin e ekzekutivit. Në mbledhjen e fundit ku kanë qenë edhe anëtarë të KKSB-së, ne ekemi trajtu edhe çështjen e përdorimit të lëndëve narkotike. Aty unë ju ftova që të bashkërisht të bëjmë një plan veprimi të komunitetit kundër përdorimit të narkotikëve dhe që nga ajo ditë, asnjëri nga ju nuk ka ardhë në zyrë që të diskutojmë rreth kësaj çështje. Në çdo takim apo eveniment që organizohet në Prishtinë dhe vende të tjera dhe na dërgohen ftesa, ne i adresojmë shqetësimet e juaja.

Selman Vila: Mes propozimeve që u përmendën këtu, nuk e dëgjova për rrugën Gllloboqicë-Hani i Elezit, se a është në plan edhe se kur mundet me u përfundu? Si dhe bashkëpunimi i Komunës me fshatrat, sidomos me fshatin Gorancë është jashtëzakonisht në nivel të mirë, ku edhe vërehen rezultatet që u përmendën, dhe për këtë dua të ju falënderoj juve, Administratorin e fshatit, banorët, diasporën dhe Sharrcemin, të gjithë ata që kanë qenë shumë aktivë. Një mundësi për ndonjë projekt tjetër është edhe rruga Krevenik-Gorancë , që do ta mundësonte edhe një pushimore që i themi te Qamat, që frekuentohet jashtëzakonisht shumë edhe nga të rinjtë, që do të mund të realizohet si hapësirë rekreative, madje edhe për shteg të biçikletave dhe desha me dit a ka ndonjë planifikim për këtë çështje?

Mehmet Ballazhi: Tek dëgjimi publik që e kishim për KAB-in, e diskutuam edhe këtë çështje dhe edhe aty ju thash që nuk e kemi përfshi për vitin e ardhshëm sepse kemi mungesë të mjeteve

dhe ideja nuk është që ne të marrim projekte që t'i vendosim në letër dhe të mbesin për shumë vite vetëm si projekte në letër, duke e ditur se mundësitë buxhetore nuk janë. Dhe si parim nga QEVERIA dhe Ministrinë është që nëse një projekt i caktuar vendoset për disa vite radhazi në letër si planifikim dhe nuk realizohet, ai projekt hiqet me automatizëm nga lista e projekteve të planifikimeve dhe kështu ne mund edhe të penalizohemi duke mos na e lejuar më këtë projekt si projekt propozim. Dhe ne vetëm pasi të jemi të sigurt që i kemi mundësitë buxhetore dhe besojmë se mund të realizohet si projekt, atëherë ne e fusim si projekt në listën e planifikimeve. Gjithashtu edhe te pjesa e Pishave, ne kemi bërë bisedime dhe edhe aty shihet se ka vështirësi në realizim përshkak të rrugës Gorancë Krevenik. Ne fillimisht e kemi bërë hartimin e kësaj rruge që ka qenë i kushtueshëm, e që vitin e kaluar i kanë planifikuar vetëm 5 mijë euro që të investohen sivjet në këtë rrugë vetëm për hartimin e projekteve, ndërkaq vetëm ky projekt ka kushtu 9,800€. Dhe me kufizimet buxhetore që kemi, ne do të mundohemi që ato mjete në dispozicion t'i orientojmë në projekte që janë më me prioritet dhe më urgjente. Megjithatë, ne si ide i kemi dhe do t'i marrim parasysh për realizim, sapo të shohim se do të kemi mundësi realizimi, duke i joshur edhe bizneset dhe diasporën për të investu. Dhe i mbetja borxh Visarit për çështjen e ambientit. Ne sot kemi pasur debat publik të organizuar nga Sharrcem mbi ndikimin mjedisor, dhe kur kanë dhe një pjesë e stafit ishim në vizitë studimore në Greqi te fabrika e Titanit, ne e kemi përcjellë procesin e djegies së këtyre lëndëve alternative për energji që i nevojitet Titanit atje ose Sharrcemit këtu, sepse është e njëjta fushë e veprimtarisë dhe ne pamë që ky proces i djegies së lëndëve alternative ishte një sistem i mbyllur dhe sipas analizave, nëse përdoret kjo metodë, ndotja e ambientit zvogëlohet për 20%. Dhe ndotja nuk ndodh vetëm prej Sharrcemit, por edhe prej përdorimit të përditshëm nga vet ne, si me automjete, konsumim të cigares apo edhe me djegie të drunjve e të tjera dhe në debat sot u paraqit se parametrat e ndotjes të kësaj procedure nga Sharrcem ishte brenda normave të lejuar, por nëse ne shohim se kjo rrite dhe del diçka në dëm të qytetarëve, padyshim se ne do të veprojmë.

Selman Curri: Jam mësimdhënës në shkollën fillore "Ilaz Thaçi". Ju përshëndes për punën e bërë dhe raportimin e sotëm. Tek fabrika e ujit, nuk kana ajo si pronë e AKP-së apo se çfarë prone, nuk di se qysh stafi i kalum komunal ka punu në atë pronë përderisa është pronë e huaj. Te uji i pijes në fshatin Dimcë, dihet se mbi atë gjendet fshati Dermjak dhe ujërat e zeza të Dermjakit, ndoshta jo drejtpërdrejt por për qat lum bijnë, edhe pse janë vç tre shpi, por sot secila shpi përdorë mjete të ndryshme helmuese dhe ato derdhen në qat lum dhe nëse nuk rregullohet një vend i posaçëm për shkarkim të atyre ujërave, nuk di se si mund të bëhen punime në fabrikë të ujit të pijes.

Mehmet Ballazhi: Problemi i ujit të pijes atje është shumë vjeçar dhe normalisht nuk mundet me u zgjidh ky problem për kaq pak muaj sa jemi ne në qeverisje. Te shpronësimi, edhe sa kam qenë në opozitë, kam pas kritikë se pse nuk kanë fillu procedurat e shpronësimit e më pas të zhvillohen punimet dhe ne tashmë jemi në fazën e fundit të shpronësimit të asaj parcele.

Visar Hasllari: Edhe një herë, du me i falënderu juve dhe drejtoritë që kanë qenë bashkëpunues me ne si shoqëri civile, duke fillua nga drejtoresha e administratës që shumë shpejt iu është përgjigjur kërkesave tona, poashtu edhe drejtoreshën e zhvillimit ekonomik për ndihmën me rastin e aplikimeve për nëngrantet në vlerë prej 50 mijë dollarëve, dhe keni falënderime dhe mirënjohje edhe nga studentët jashtë Kosovës që ua keni mundësu aplikimin dhe mundësinë e përfitimit të bursave. Unë e kam edhe një kërkesë, që seancat live që po zhvillohen q shumë mir q

kan fillu me u transmetu edhe live, por kërkesa është që të vendoset një pajisje e re që ta dimë se kush po flet, sepse ndonjëherë nuk po vërehet se kush po flet.

Mehmet Ballazhi: Puna e transmetimit live të Kuvendit, unë kam kërku që nga mandati im i parë si asambleist, por nuk është realizu, dhe ne kemi kërku alternativa se si me realizu këtë gjë, dhe diku kushtojke 14 mijë € dhe ne nuk kemi buxhet të planifikum nga viti i kalum për këtë vit, gjë e cila po përsëritet shpesh, por kështu janë kushtet.

Kimete Kuka Hasallari: Meqenëse jemi në fund të Debatit Publik, po e shfrytëzoj këtë takim që të ju njoftoj se nesër me datë 1 korrik, duke filluar nga ora 12:00-15:00 do të zhvillohet aksion për dhurimin e gjakut tek ambientet e Shtëpisë së Kulturës.

Mehmet Ballazhi: A keni edhe ndonjë diskutim për Raportin gjashtëmujor që u prezentua sot? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur Debatin publik.

Mbledhja përfundoi në ora 17:08

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

